

## **KANDIDATI PA ILUZIONE**

**Author:** [Davor Lukac](#)

Ai mund te jete kandidati presidencial i ish partise ne pushtet - por Velimir Bata Zhivojinoviq e di se nuk ka asnje shans per te fituar.

Aktori i njohur i kinematografise Serbe Velimir Bata Zhivojinoviq e di se nuk ka asnje shans per te fituar zgjedhjet presidenciale te 29 Shtatorit, por kandidatura e tij eshte teper domethenese sepse partia e tij, Partia Socialiste e Serbise, SPS, shpreson se ky hap do te ndihmoje ate te distancohet nga ish drejtuesi i saj Slobodan Millosheviq dhe gruaja e tij e pushtetshme, Mirjana Markoviq.

Muajin e kaluar, komiteti drejtues i SPS ka vendosur te mos pranoje udhezimet e leshuara prej Millosheviqit nga qelia e tij e burgut per te mbeshtetur Vojisllav Sheshelj, drejtuesin e Partise Radikale Serbe, SRS, si kandidat ne zgjedhjet presidenciale.

Shume anetare te SPS kane dyshuar se Markoviq, duke dashur te shtoje influencen e saj brenda partise se burrit, ka vendosur te mbeshtese kandidaturen e Sheshelj. Ky hap ka percare partine, dhe disa nga anetaret e saj nacionaliste kane vendosur te mbeshtesin politikanin ultra nationalist.

Percarjet ne gjirin e SPS jane bere te dukeshme menjehere pas transferimit te ish presidentit Jugosllav ne Hage, ndersa krahu i majte dhe ai nationalist i partise jane perplasur ne menyre te hapur per kontrollin e partise ne te ardhmen.

Perplasjet ne gjirin e drejtuesve te partise kane shkaktuar konfuzion dhe habi ne rradhet e anetareve dhe perkrahesve te SPS. Duke zgjedhur Zhivojinoviq, nje njeri popullor dhe te njohur per publikun fale roleve te tij ne kinematografi, drejtuesit e partise jane perpjekur te rivendosin besimin ne rradhet e anetareve dhe te ringrene SPS si forcen kryesore politike ne spektrin e majte.

Megjithese Millosheviq mbetet nje drejtues i partise, Zhivojinoviq eshte zgjedhur ne postin e zevendes kryetarit per te shtuar shanset e tij elektorale.

Ne karrieren e tij 45 vjecare ne kinematografi, Zhivojinoviq ka pasur role ne mbi 250 filma dhe drama televizive. Ende aktori me popullor ne ish Jugosllavi, ai eshte vecanerisht i njohur per portretet e tij te komandanteve partizane te Luftes se Dyte Boterore dhe heronjve ne filma si Walter Mbron Sarajevon - gje te cilen mendon ta shfrytezoje SPS.

Zhivojinoviq eshte anetaresuar ne parti menjehere pas krijimit te saj, dhe ka filluar karrieren politike aktive mbi dhjete vjet me pare, duke qene nje deputet i thjeshte per 12 vjet dhe dy here kryetar i komisioneve parlamentare - detyra te cilat sipas kolegeve te tij ai i ka kryer me dedikimi dhe eficience.

Nje nga pikat me te forta te kandidatures se re te SPS eshte reputacioni i tij i mire - Zhivojinoviq nuk eshte perfshire asnje here ne skandale financiare dhe njihet si nje politikan i cili ka shmangur fjalorin e mbushur me urrejtje dhe sharje i cili eshte i zakonshem ne politiken Serbe.

Megjithese me pare kete muaj, Zhivojinoviq, duke akuzuar Markoviq se ka komplotuar per te zgjedhur Sheshelj si kandidat te SPS, e ka quajtur gruan e Millosheviqit nje "shtrige te kuqe", duke perseritur nje sharje, qe per ironi te fatit eshte perdorur me pare nga Sheshelj ne vitin 1994.

Zhivojinović ka thënë se ai dyshon mbi faktin që Millošević të ketë bërë thirrje partise se tij të mbështesë Sheshelj-in sepse në rrugë të parë "keto fjale kanë ardhur nëpërmjet ndërmjetësve" dhe pastaj sepse "kryesia e SPS nuk ka qenë në kontakt direkt me Millošević-in që prej katër muajsh".

Ai ka akuzuar zyrtarin e lartë të SPS Bogoljub Bjelić dhe disa zyrtarët e tjerë të lartë të partise se kanë bashkëpunuar me Marković dhe kanë "falsifikuar" mesazhe nga Millošević dhe kanë inkurajuar anëtarë të SPS të anëtarësohen në SRS.

Në fjalimet e tij, Živojinović ka sulmuar dhe kritikuar Opozitën Demokratike të Serbisë, DOS, koalicionin e tanishëm qeveritar, por me pak se cka bërë Sheshelj.

Duke qenë koshient për shanset e tij të pakta për të fituar këto zgjedhje, ylli i kinematografisë është shpesh ironik, dhe në një fare mënyre i pakujdesëshëm në komentet e tij gjatë takimeve elektorale.

Duke vënë në lojë arritjet e qeverisë së tanishme, ai ka thënë: "Gjatë dy vjetëve të fundit DOS ka mundur të shkatërrojë shtetin më tepër se sa në gjatë një dekade".

Živojinović nuk ka një program elektorale të tijin, por ka marrë pjesë nga platforma e vjetër elektorale e SPS, e cila ka ndryshuar fare pak gjatë dekadës së fundit. Politika e partise është si gjithnjë e dominuar nga thirrjet për drejtësi sociale dhe luftë ndaj kriminalitetit.

Në fillim të fushatës së tij, Živojinović ka thënë se synimi i tij është të përcaktojë se sa respekt dhe mbështetje i ka mbetur SPS, por se ai nuk kishte ndonjë iluzion. Ai ka thënë gjithashtu se edhe nëse ai zgjidhet president, kjo nuk do të mjaftonte që SPS të vinte në pushtet në Serbi.

Dejan Lukac është gazetar i agjensisë së lajmeve Tanjug në Beograd.

**Location:** [Balkans](#)  
[Serbia](#)

---

**Source URL:** <https://iwpr.net/sq/global-voices/kandidati-pa-iluzione>